



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më 13.10.2025

**MBLEDHJA Nr. 41,
Datë 15.10.2025, ora 10:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 15.10.2025, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 41 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën për rivlerësim të të Ardhurave të FSHU sh.a. dhe çmim të diferencuar të shitjes së energjisë për karikim makinash.
2. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 02.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, i ndryshuar.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**